



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1713/24, Datë: 20/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

I. Zgjatet periudha e riakreditimit e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës për periudhën një (1) vjeqare 01.10.2024 deri 30.09.2025, për programet e studimit:

1. *Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 ECTS;*
2. *Prodhim Shtazor, BSc 180 ECTS;*
3. *Prodhim Bimor, BSc 180 R;*
4. *Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 ECTS;*
5. *Shkencat e Aplikuar në Zooteknë, MSc 120 ECTS;*
6. *Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 ECTS;*
7. *Mbrojtja e bimëve – Fitomedicinë, MSc 120 R;*
8. *Pemëtari - Vreshtari, MSc 120 R;*
9. *Mjekësi Veterinare, DMV 300 ECTS;*

II. Për këtë periudhë të riakreditimit vlejnjë kriteret dhe kuotat e njëjta sikurse në vendimin e fundit të KShC-së Ref.3018/21 datë 12.08.2021, me të cilin ishin ri/akredituar programet si në par.I të këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 ECTS;</i>	Arben Musliu Jehona Shkodra, Prespa Ymeri Fatos Krasniqi
2.	<i>Prodhim Shtazor, BSc 180 ECTS;</i>	Muhamet Kamberi Alltane Kryeziu Skender Muji

Faqe 1 nga 2

3.	<i>Prodhim Bimor, BSc 180 R;</i>	Sali Aliu Gezim Hodolli Imer Haziri
4.	<i>Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 ECTS;</i>	Xhavit Ramadani Salih Salihu Driton Sylejmani
5.	<i>Shkencat e Aplikuarra në Zootekni, MSc 120 ECTS;</i>	Bajram Berisha Blerta Mehmedi Kastrati
6.	<i>Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 ECTS;</i>	Iliriana Miftari Nijazi Bytyqi
7.	<i>Mbrojtja e bimëve – Fitomedicinë, MSc 120 R;</i>	Arben Mehmeti Fadil Musa
8.	<i>Pemëtari - Vreshtari, MSc 120 R;</i>	Vahid Avdiu Bedri Dragusha
9.	<i>Mjekësi Veterinare, DMV 300 ECTS;</i>	Agim Rexhepi Behlul Behluli Izedin Goga Afrim Hamidi Fatgzim Latifi

Fillimisht KShC me vendimet Ref.:872/24 dt.10.05.2024 dhe vendimin Ref.:1077/24 dt.30.05.2024, ka refuzuar programet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës pasi që bazuar në raportet përfundimtare të ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë nuk ishin plotësuar standardet obligative të përcaktuara me Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), për riakreditimin e këtyre programeve.

Mirëpo KShC pas pranimit të njoftimit me shkrim nga MASHTI se programet në fjalë konsiderohen me interes kombëtar, ka marr në rishqyrtim kërkesën për programet në tabelë me bartësit përkatës si dhe rekomandimin e Komisionit të ankesave, dhe pas rishqyrtimit ka ardhur në përfundim se duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 27, të riakreditoj programet e lartpërmendura për një periudhë një (1) vjeçare.

KShC në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi do të monitoroj në vazhdimësi Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës me qëllim që të sigurohet se ky institucion ju përmbahet kritereve të përcaktuara të riakreditimit të cilat i janë dhënë për një periudhë një (1) vjeçare. Në të kundërtën KShC rezervon të drejtë e tërheqjes apo ndërprerjes së riakreditimit sipas dispozitave ligjore në fuqi, nëse monitorimi nga AKA konstaton mos përmbushje të kritereve minimale të riakreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në kompetencat ligjore, autorizimet dhe diskrecionin, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Faqe 2 nga 2